

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/07/27

Data (viti/muaji/dita)

+355696407424

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-75647-07-20-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Identitek Sh.a

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

4981157

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

“Blerje Materiale Kancelarie”

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/07/31

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/07/31

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

75647

22816000-322852000-730192110-530192124-

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Ligji Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar; Vendimi i KPP nr.551/2022, datë 09.06.2022.

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

□

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Më datë 21.07.2023, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është shpallur nga autoriteti kontraktor, “Identitek” SHA “Procedure e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje Materiale Kancelarie” me fond limit 4,981,157 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, me REF-75647-07-20-2023.

Në shtojcën 7(Formular i i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit) të DT-së janë kërkuar:

[...5.Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.

Nr.	Emertimi i produktit/Lëndës se parë	Vendi i origjinës Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
-----	-------------------------------------	---

1

2

Etj.,

Shënim 5.1:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar.

6.Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqes prane AK per cdo produkt certifikatat e origjinës. Per kete te paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me certifikatat përkatëse të origjinës....]

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Shoqëria “Infosoft Office” SHPK, si një kompani e fushës dhe e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, pasi u njoh me dokumentat e tenderit, vlerëson se, një pjesë e kritereve për kualifikim duhet të ndryshohen.

Për këto arsye, mbështetur në pikën 1 të nenin 110 (Afatet për ankim) të ligjit 162/2020 ”Për

Prokurimin publik” ku përcaktohet se: “...1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë?.”, brenda afatit ligjor, paraqet ankesën e saj si më poshtë vijon:

Në lidhje me specifikimin teknik : “[...5.Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.

Nr.	Emertimi i produktit/Lëndës se parë	Vendi i origjinës Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
-----	-------------------------------------	---

1

2

Etj.,

Shënim 5.1:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar....”,

6.Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqes prane AK per cdo produkt certifikatat e origjinës. Per kete te paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me certifikatat perkatëse të origjinës....] kërkojmë të hiqen për arsytet si më poshtë:

Së pari:

Në nenin 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet:  
”Neni 77 (Kërkesat për kualifikim)

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Ne nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP përcaktohet:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet?

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e

kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi OSE ORIGJINË APO PRODHIM SPECIFIK, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente” ?)

Në nenin 40 (Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave) të VKM 285/2021 për kontratat e mallrave përcaktohet si më poshtë vijon:

“?1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t’argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike?”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“?1. Autoriteti/entë kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit?”

Në nenin 55 (Procedurë e hapur e thjeshtuar) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht se:

[...1. Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, q? mund p?rdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit n? nenin 49, t? LPP-s?.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund t? paraqes? nj? ofert? n? k?t? procedur?.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato t? parashikuara në nenin 49, të LPP-së.

4. NË KËTË LLOJ PROCEDURE PROKURIMI, AUTORITETET KONTRAKTORE DUHET TË MBAJNË NË KONSIDERATË TË PËRCAKTOJNË KRITERE TË THJESHUARA PRANIMI, ME QËLLIM NXITJEN E PJESËMARRJES SË BISNESIT TË VOGËL DHE TË MESËM....]

Së dyti:

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave, autoriteti kontraktor i ka argumentuar kriteret e mësipërme për kualifikim si më poshtë:

Kriterin për kualifikim të përcaktuar anë pikën 5 të shtojcës 7 të DT-së “...Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi...) por, pa specifikuar ligjin konkret apo direktivën konkrete ku përcaktohet që për produktet objekt prokurimi, artikj kancelarie, duhet të, pra është e detyrueshme që prodhuesit apo tregëtuesit e tyre duhet te kenë për to, Certificate konformiteti ose cilesie CE ose ekuivalente, te leshuar nga nje organ i akredituar kombetare ose nderkombetar.

Kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 6 të shtojcës 7 të DT-së ”...Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi”.

Në këtë procedurë prokurimi kërkohet të furnizohen mallra kancelarie të tillë si, axhenda ditore; dosje të ndryshme, zarfa, bateri të vogla, evidenciatorë, kapse të ndryshme aktesh, heqëse teli, stika, letër fotokopje, blloqe porosish, etiketa, etj., pra artikuj të thjeshtë kancelarie, të cilat i gjen lehtësisht në treg dhe që nisur nga natyra e tyre, sipas legjislacionit të fushës, prodhuesit, distributorët apo tregëtarët nuk e kanë detyrim ligjor që në nxjerrjen e tyre në treg detyrimisht ti shoqërojnë këto mallra me certifikata konformiteti ose cilesie CE” ose ekuivalente, të leshuara nga një organ i akredituar kombëtare ose nderkombëtar.

Pra, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë të paraqiten për efekt kualifikimi në procedurën e prokurimit, dokumente të tilla si Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent, për mallrat për të cilat ligji nuk ja kërkon prodhuesit/distributorit/ tregëtarit si kusht për vendosjen e tyre në treg. Një kriter i tillë pengon dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pasi pamundëson pjesëmarrjen e tyre për shkak se certifikime të tilla nuk ekzistojnë ose janë të vështira për t’u siguruar edhe nëse për artikuj të veçantë edhe ndoshta mund të lëshohen certifikime të tilla.

Bazuar në legjislacionin e prokurimit public, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim nga AK-ja, ka si synim kryesor që t’i shërbejë atij, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, por gjithshmonë këto kërkesa duhet të jenë të ligjshme dhe të mundshme për tu plotësuar.

Në rastin konkret procedura e prokurimit për shkak të vlerës monetare është procedurë e hapur e thjeshtuar për të cilin legjislacioni I prokurimit public e konkretisht në nenin 55 (Procedurë e hapur e thjeshtuar) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcakton shprehimisht në pikën 4 të tij se:

“...4. NË KËTË LLOJ PROCEDURE PROKURIMI, AUTORITETET KONTRAKTORE DUHET TË MBAJNË NË KONSIDERATË TË PËRCAKTOJNË KRITERE TË THJESHTUARA PRANIMI, ME QËLLIM NXITJEN E PJESËMARRJES SË BISNESIT TË VOGËL DHE TË MESËM....]

Për sa më sipër, legjislatori e detyron autoritetin kontraktor që për procedura të hapura të thjeshtuara të kërkojë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kjo kërkesë lidhet e dhe me faktin se për këtë lloj procedurash prokurimi afati që kanë operatorët ekonomikë për të përgatitur ofertat e tyre është i shkurtër dhe në rastin konkret nga AK-ja, është lënë në dispozicion OE-ve për të përgatitur ofertat e tyre afati prej 10 ditësh, ndërkohë që në listën e artikujve të kërkuar nga AK-ja janë 59 artikuj kancelarie.

Së treti:

Kërkesa e autoriteti kontraktor që OE- të duhet të deklarojnë se ata do të dorëzojnë jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, certifikata CE për të gjithë mallrat objekt prokurimi është një kërkesë e ekzagjeruar, e pamundur për tu realizuar pasi, Certifikata CE nuk lëshohen për të gjitha produktet e objekt prokurimi, por për produktet e përcaktura sipas direktivave të Bashkimit Evropian. Për shembull, lodrat, pajisjet elektrike, makineritë, pajisjet



medicinale, ashensorët dhe pajisjet mbrojtëse personale janë produktet dhe grupet e produkteve që aplikojnë CE Marking. Direktivat përkatëse përcaktojnë kërkesat themelore që duhet të përmbushin produktet. Pra jo të gjitha produktet duhet të marrin markimin apo certifikatën CE.

Në vlerësojmë se, mallrat object prokurimi nuk përfshihen në listën e produkteve për të cilat duhet të sigurohen certifikatat e cilësië CE.

Referuar nenit 9, pika 3 të Ligj Nr.10489/2011 markimi CE i konformitetit vendoset vetëm në produktet, për të cilat është parashikuar vendosja nga rregullat teknike dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjera.

E konkretisht në Nenin 8 dhe 9 te ligjit Nr.10 489, datë 15.12.20111 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” citohet se:

#### “NENI 8 DEKLARATA EC E KONFORMITETIT

1. Kur legjislacioni përkatës parashikon një deklaram nga prodhuesi se ai ka demonstruar përmbushjen e kërkesave për një produkt, prodhuesi harton një deklaratë të vetme EC të konformitetit për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse.
2. Deklarata EC e konformitetit hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe dhe përmban elementet e mëposhtme: a) numrin e identifikimit unik të produktit; b) emrin dhe adresën e prodhuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar; c) objektin e deklaramit (identifikimin e produktit, që mundëson gjurmueshmërinë, kur është e përshtatshme mund të përfshijë edhe një fotografi), në përputhje me legjislacionin përkatës në lidhje me të; ç) referencën ndaj standardeve të harmonizuara përkatëse që janë zbatuar ose referencën ndaj specifikimeve teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar përputhshmëria; d) kur është e aplikueshme, organizmin europian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar si organ i miratuar (emrin, numrin e identifikimit), duke treguar procedurën e vlerësimit të konformitetit dhe lëshimin e certifikatës; dh) datën, vendin dhe nënshkrimin.

3. Kjo deklaratë konformiteti lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit ose, sipas rastit, instaluesit. 4. Me hartimin e deklaramit EC të konformitetit, prodhuesi ose, sipas rastit, instaluesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore në lidhje me to.

#### NENI 9 (MARKIMI CE I KONFORMITETIT)

1. Markimi CE i konformitetit vendoset vetëm nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.
2. Markimi CE i konformitetit fiksohet në produkt përpara vendosjes së tij në treg. Ai mund të shoqërohet nga një piktogram ose ndonjë tregues për një përdorim ose rrezik të veçantë.
3. Markimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet vetëm në produktet, për të cilat është parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike të zbatueshme dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjera.
4. Markimi CE i konformitetit shoqërohet nga numri i identifikimit të organizmit europian të notifikuar, kur ky organ është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit. Numri i identifikimit të organizmit europian të notifikuar vendoset/fiksohet nga vetë ai ose, sipas instruksioneve të tij, nga prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar. Me vendosjen ose fiksimin e markimit CE të konformitetit, prodhuesi merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me të gjitha kërkesat e zbatueshme, të përcaktuara në legjislacionin përkatës/rregullat teknike që parashikojnë vendosjen e tij.
5. Forma, kuptimi dhe simboli grafik i markimit të konformitetit përcaktohen në rregullat teknike përkatëse, referuar në nenin 5 të këtij ligji.
6. Ndalohet vendosja e markimit/markimeve, shenjave apo mbishkrimeve, të cilat mund të çorientojnë palët e treta për kuptimin, formën e markimit CE të konformitetit, të përcaktuar në rregullat teknike përkatëse. Çdo markim tjetër mund të vendoset në produkt, në mënyrë të tillë që të mos pengojë dukshmërinë, lexueshmërinë dhe kuptimin e markimit CE të konformitetit.
7. Markimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të

paheqshme në produkt ose në pllakën e tij të të dhënave. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së produktit, markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese, në qoftë se rregulli teknik përkatës parashikon dokumente të tilla.

8. Kur produkti mbulohet nga disa rregulla teknike, vendosja e markimit CE të konformitetit në produkt tregon se produkti i plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në rregullat teknike përkatëse për këtë produkt?”.

Së katërti:

Kërkesa e AK-së për deklarimin e origjinës së mallrave , pra të 59 artikujve të kancelarisë, është ekzagjeruar dhe nuk është në përputje me objektin e prokurimit. Në pikën 4 të nenit 36 të LPP, përcaktohet se: “4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi OSE ORIGJINË APO PRODHIM SPECIFIK, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”?), për sa më sipër kërkesa për të përcaktuar origjinën e produkteve është e pakuptimtë pasi origjina e produkteve nuk mund të jetë kriter vlerësimi për sa kohë ligji nuk të lejon të kualifikosh apo skualifikosh një ofertues nisur nga origjina e mallit me të cilin ai oferton.

Autoriteti kontraktor gjithashtu ka kërkuar që: “..Shënim 5.1: Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar...”

Kërkesa e mësipërme jo vetëm që nuk bazohet në asnjë dispozitë ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, por nga ana tjetër është një kërkesë e cila lë vend për dyshim pasi e kërkuar që të dorëzohet jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, pra kur vlerësimi përfundimisht ka përfunduar, jo vetëm që nuk i shërben qëllimit për të cilin vendosen Kriteret ( për të kualifikuar ose jo një OE ), por le vend edhe për abuzim si nga e AK , por edhe nga ana e OE, i cili pasi është shpallur fitues përfundimisht, anashkalon këtë detyrim.

Pra kjo kërkesë shkel qëllimin dhe parimet e përcaktuara në nenin 2 dhe në nenin 3 të LPP-së e konkretisht:

- nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- nuk siguron integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public.

Në pikën 6 të kapaciteti teknik, të shtojcës 7 të DT-së autoriteti kontraktor ka kërkuar që: “...6.Me nënshkrimin e kontratës dhe dorëzimin e artikujve operatorit ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi të paraqes pranë AK për cdo produkt certifikatat e origjinës. Për këtë të paraqes detyrimisht një deklaratë se cdo produkt do të shoqërohet me certifikatat përkatëse të origjinës...”

Duke qënë se certifikata e origjinës mund të lëshohet vetëm nga prodhuesi i artikujve të kancelarisë atëherë pajisja me certifikatën e origjinës për të 59 artikujt e kërkuar nga AK-ja kthehet në një kërkesë tepër të vështirë për tu përmbushur, ndërkohë që nëpërmjet kësaj kërkesë AK-ja nuk arrin të vërtetojë asgjë në lidhje me cilësinë e produkteve pasi certifikata e origjinës është një dokument i cili lëshohet nga prodhuesi por që në të nuk përcaktohen specifikime apo të dhëna teknike për produktet. Thjesht tregon origjinën, vendin ku është prodhuar produkti. Për më tepër që, tashme referuar praktike të importit të këtyre llojve mallrave nuk është detyrim ligjor që mallrat të lëshohen me certifikatën e origjinës së tyre.

Në vendimet e saj KPP-ja shpesh e ka vënë në dukje faktin se, vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Ne Vendimin nr.551/2022, datë 09.06.2022, Komisioni i Prokurimit Publik në një rast të ngjashëm, ka arsyetuar: (...Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon se bazuar në objektin e procedurës së prokurimit, volumit dhe elementeve konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat e mësipërme për disponimin e certifikatave të konformitetit ose të cilësisë CE/Ekuivalent, si dhe certifikatën e origjinës, ku krahas kësaj detyrimisht dhe deklaratën se çdo produkt do të shoqërohet me certifikatat përkatëse sipas specifikimeve të AK, janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë produktin, por duke u siguruar me cilësinë e saj me anë të një kërkesë për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Kërkesa për disponimin e deklaratës, certifikatave të konformitetit ose cilësisë CE/ekuivalent, dhe për çdo produkt certifikatën e origjinës, nuk është tepër e domosdoshme për zbatim me sukses të një kontrate, pasi nuk është aq komplekse. Gjithashtu, në bazë të shqyrtimit në DST të procesverbalit për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, KPP vëren, se në lidhje me kriterin e vendosur, autoriteti kontraktor nuk e ka argumentuar teknikisht vendosjen e saj. Akoma më tej, kriteret e veçanta të kualifikimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në 7 funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe vendosja e togfjalshit në kriterin e mesipërme “Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik” Autoriteti Kontraktor kërkon përmbushjen e këtij kriteri pas fazës së vlerësimit të ofertave dhe njoftimit të fituesit, pra ky kriter nënkupton përmbushjen nga operatori ekonomik fitues dhe jo pjesëmarrësit e saj pas njoftim-fituesit, gjë e cila krijon konfuzion dhe është në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. LPP 162/2020. Për sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin?”

Për gjithë sa më sipër argumentuam, kërkojmë heqjen e kritereve për kualifikim të percaktura në pikën 5 dhe 6 të kapaciteti teknik të shtojcës 7 të DT-së, si kritere të cilat janë të ekzagjeruara, të pamundura për t’u plotësuar, kufizuese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin e prokurimit public dhe me ligjet sektoriale të fushës, dhe të paargumentuara nga autoriteti kontraktor.

Të nderuar,

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Ne lidhje me specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi, kerkojme sqarime si me poshte:

? Per artikullin Nr. 1 AK ka kerkuar:

1 Axforditore afërsisht 14.2x20.5 cm, min 300 faqe Axforditore të ketë përmasat 14.2x20.5 cm (? 2 cm marzh gabimi), minimumi të ketë 300 faqe, të shkruhet viti, me logo ose jo sipas kërkesës së AK, me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK. copë 400

Te saktësohet nga ana e AK, nese artikulli i mesiperme nevojitet te jete me logo ose jo pasi ka ndryshime ne koston e produktit dhe kjo ndikon ne ofertimin qe do te behet nga ana jone ne lidhje me kete artikull.

? Per artikullin Nr. 14 AK ka kerkuar:

14 Evidenciator 4 ngjyra 4 ngjyra te ndryshme, maja minimumi 4.5 mm, përmasat 12.4x1.75x1.2cm, të mos fshihet. pako 150

Vendosja e permasave te trupit, aq me teper ne parametra kaq fikse, nuk ndikon fare ne funksionalitet te produktit. Kerkojme te hiqen permasat e trupit per kete artikull.

? Per artikullin Nr. 22 AK ka kerkuar:

22 Heqëse teli pincë Të ketë formën standarde, madhësi normale, me sustë. Të jetë material inoxi, të ketë formën e pincës. copë 300

Materiali i artikullit te mesiperme nuk ndikon aspak ne funksionalitetin e tij, perkundrazi nga eksperiencia jone perdoren me shume heqeset e telit me doreze plastike, duke qene se jane me te pershtatshme per doren.

? Per artikullin Nr. 24 AK ka kerkuar:

24 Makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë gërrshërë Makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë pice. Materiali metalik. Të kapë 30 fleta. Përmasa: minimumi 17.5 cm. copë 210

Parametri që percakton numrin e fleteve, është përmasa e telit (në rastin konkret 24/6) kërkesa për numrin e fleteve (30 flete), materiali metalik dhe gjatësia e makines minimumi 17.5 cm, krijojnë konfuzion, kufizojnë konkurrencën dhe nuk ndikojnë në funksionalitetin e këtij artikulli.

? Per artikullin Nr. 27 AK ka kerkuar:

25 Marker permanent Kutë 4 ngjyrëshe Marker permanent kutë 4 ngjyrëshe, majë 1.2mm.pako 30

Maja fikse 1.2 mm kufizon konkurrencën dhe ka një diapazon fikse. AK duhet të pranohet dhe një marker me një majë me të trashë.

? Per artikullin Nr. 27 AK ka kerkuar:

27 Lapsa me gome HB Laps grafiti me gomë për përdorim të përgjithshëm me fortësi HB. Të jetë material cilësor pako 12 copë. Pjesa e jashtme e lapsit të jetë me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së. copë 30

Vendosja e kriterit për pamjen e jashtme të lapsit është e ekzagjeruar dhe nuk ndikon aspak në funksionalitetin e tij. Gjithashtu për këtë artikull është e paqartë sasia që nevojitet, nëse duhet të jetë 30 cope apo 30 pako? Ju lutem saktësoni sasinë që dëshironi për këtë artikull.

? Per artikullin Nr. 37 AK ka kerkuar:

37 Leter fotokopje, 80 gr/m?, double A Double A ose ekuivalente risma 500 flete 3

Ju lutem specifikoni përmasat e sakta të letres që kërkohet.

? Per artikullin Nr. 41 dhe 42 AK ka kerkuar:

41 Zarfa 19x26 cm (A5) sigurie me numer serie Zarfi të ketë përmasat 19x26 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë. copë 70  
42 Zarfa 23x33 cm (A4) sigurie me numer serie Të jenë letre, përmasat 23x33 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë. copë 70

Ju lutem për këto dy artikuj, nga ana e AK të jepen me shumë specifikime teknike dhe të mundësojnë një foto ilustruese të produktit që kërkohet.

? Per artikullin Nr. 45 AK ka kerkuar:

45 Leter A5 për printer Epson LQ-350 Leter e vazhdueshme me vrima në ane. copë 15

Ju bëjmë me dije se letra e vazhdueshme është me një, dy ose tre opje. Ju lutem saktësoni sa kopje

deshironi.

? Per artikullin Nr. 45 AK ka kerkuar:

50 Kablla per MSOKabëll per lidhje me porta te tipeve te ndryshem. copë 30

Nuk e kemi te qarte ate cfare kerkohet nga AK. Ju luem na mundesoni me shume secifikime teknike dhe foto ilustruese te produktit qe ju kerkoni.

? Per artikullin Nr. 54 AK ka kerkuar:

54 Kompjuter Seal Vula plastike me numer serie per mbylljen nga mbrapa te kompjuterave.  
copë 1,200

Nuk e kemi hasur ndonjehere kete kerkese pasi ky artikull nuk eshte produkt kancelarie. Ju lutem, na jepni me shume specifikime dhe nje foto ilustruese te produktit.

? Per artikullin Nr. 57 AK ka kerkuar:

57 Qese per shredder Kobra Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat  
grirese copë 60

Ju lutem saktsoni se cfare modeli Kobra, pasi modele te ndryshme perdorin qese te ndryshme.

##### 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)*

---

##### 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

nuk ka

---

##### 7. Lista e informacionit konfidencial:

nuk ka

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose*

*një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.* □

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

aarapi@infosoftoffice.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Frederik Prodani